



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1017/23 Datë: 26/07/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohen programet e studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2028):
  1. *Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
  2. *Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi MSc 120 ECTS (R) me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohen programet e studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
  1. *Juridik LLB 240 ECTS (R) me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik;*
  2. *Biokimi MSc 120 ECTS (A) me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
  3. *Psikologji BSc 180 ECTS (R) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I dhe II zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I dhe II, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik dhe ekspertët si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (R)</i>	Aferina Skeja Fisnik Bytyqi Besnik Skenderi Amir Imeri
2.	<i>Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi MSc 120 ECTS (R)</i>	Arta Mulliqi Bekim Marmullaku
3.	<i>Juridik LLB 240 ECTS (R)</i>	Jorida Xhafaj Sevdai Morina Ahmet Maloku Bashkim Nuredini
4.	<i>Biokimi MSc 120 ECTS (A)</i>	Fisnik Laha Albina Fejza
5.	<i>Psikologji BSc 180 ECTS (R)</i>	Violeta Zefi Valdrin Krasniqi Eglantina Kraja Bardhi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi BSc 180 ECTS (R)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Katalin Kovacs dhe Christof Back, është organizuar me 01.03.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht të gjitha shtatë (7) standardet e akreditimit.
- Për programin e studimit; *Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi MSc 120 ECTS (R)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Katalin Kovacs dhe Christof Back, është organizuar me 01.03.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht të gjitha shtatë (7) standardet e akreditimit.
- Për programin e studimit; *Juridik LLB 240 ECTS (R)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Bertel De Groote dhe Juraj Bogat është organizuar më 05.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) standarde.



4. Për programin e studimit; *Biokimi MSc 120 ECTS (A)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Mladen Krajacic dhe Delia Gologan është organizuar më 06.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht katër (4) Pjesërisht tre (3) standarde.
5. Për programin e studimit; *Psikologji BSc 180 ECTS (R)* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Melita Kovacevic dhe Juraj Bogat, është organizuar më 01.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht katër (4) Pjesërisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT, kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë